

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8008
E shtunë, 8 mars 2025
Çmimi 0.50 €

Trumpi u thotë aleatëve të NATO-s t'i rrisin shpenzimet nëse duan mbështetjen e ShBA-së

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMBINIMET E MUNDSHME PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE TË KOSOVËS

FAQE 4-5



Të gjitha votat e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë më në fund u numëruan. Ndonëse rezultati ka mbetur të certifikohet, pasqyra tani është më

e qartë se kush i ka gjasat reale për ta formuar qeverinë e re. Kryeministri Kurti ka thënë të premtën se është duke pritur certifikimin e rezultatit zgjedhor,

ndërkaq liderët e opozitës, Memli Krasniqi dhe Ramush Haradinaj, kanë theksuar se opozita do ta bëjë qeverinë pas dështimit të Kurtit

KOSOVA PA ASNJË KONTRATË LOBIMI NË SHBA

F.7



Si rrallëherë në historinë e pasluftës së Kosovës, institucionet shtetërore, aktualisht, nuk kanë asnjë kontratë aktive lobimi në Shtetet e Bashkuara. Njohësit e politikave vendore dhe ndërkombëtare paralajmërojnë se kjo rrezikon ta lërë Kosovën nën hije dhe "pa një vend në tavolinë"

LIDERËT SHTETËRORE DHE PARTIAKË UROJNË PËR 7 MARS: MËSUESIT, SHTYLLA KRYESORE NË FORMËSIMIN E BREZAVE

F.8



AKTUALE



PËRPARIM RAMA EMËRON FLORIAN DUSHIN NËNKRYETAR TË PRISHTINËS

F.7

DIPLOMOI GJENERATA E 45-të E ZYRTARËVE KORREKTUES

F.7

BE-ja THOTË SE SERBIA PO E SHKEL MARRËVESHJEN ME KOSOVËN ME SJELLJEN E SAJ NË KIE

F.6

EKONOMI



GAP-i: INVESTIMET E KOSOVARËVE NË SHQIPËRI MË 2015-2024, RRETH 360 MILIONË EURO

F.8

RINISJA NGA ZEROJA: SHUMË GRAVE U MOHOMET PASURIA E PËRBASHKËT GJATË DIVORCIT

F.8

SPORT



PËRBALLJE INTERESANTE NË ELITËN E BASKETBOLLIT

F.6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi u thotë aleatëve të NATO-s t'i rrisin shpenzimet nëse duan mbështetjen e ShBA-së

WASHINGTON, 7 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e ka vënë në dyshim gatishmërinë e tij për ta mbështetur aleancën ushtarake perëndimore, duke thënë se nuk do t'u shkojë në ndihmë aleatëve të NATO-s nëse ata nuk paguajnë mjaftueshëm për mbrojtjen e vet. “Është gjë e logjikshme, apo jo?” tha Trumpi për gazetarë në Zyrën Ovale të enjten. “Nëse ata nuk paguajnë, unë nuk do t'i mbroj”, theksoi ai. Trumpi nënvizoi se ai e kishte ndarë qëndrimin e njëjtë me aleatët e NATO-s edhe gjatë mandatit të tij të parë si president, 2017-2021, çka i kishte nxitur shumicën e vendeve t'i rrisnin shpenzimet ushtarake. Por, Trumpi tha se këto shpenzime janë të pamjaftueshme. “Ata duhet të paguajnë më shumë”, shtoi ai. Gjatë mandatit të tij të parë Trumpi nguli këmbë që vendet anëtare të NATO-s t'i rrisnin shpenzimet ushtarake në 2 për qind të bruto prodhimit të brendshëm (GDP). Shkalla prej dypërqindësh ishte zotim i vitit 2014 për t'u arritur brenda

dhjetë vjetëve pasuese. Të paktën 24 vende e kanë përmbushur këtë kërkesë, megjithëse Trumpi ka sugjeruar që ky prag duhet të rritet në 5 % të GDP-së. Por, shumë vende anëtare kanë thënë se kjo do të ishte e pazbatueshme ekonomikisht. Vetëm Polonia i afrohet pesëpërqindëshit, ndonëse Estonia dhe Lituania kanë lënë të kuptohet se edhe ato do t'i rrisin shpenzimet në këtë shkallë. Pavarësisht prej qëndrimeve të fundit, Trumpi në shkurt ritheksoi përkushtimin e tij ndaj nenit 5 të mbrojtjes së ndërsjellë të NATO-s, duke folur së bashku me kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar, Keir Starmer. Ky qëndrim u përsërit disa herë - si publikisht ashtu edhe privatisht - nga sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, gjatë një takimi të ministrave të mbrojtjes të NATO-s në Bruksel, në shkurt. ShBA-ja ka një personel ushtarak prej rreth 100 000 vetash në Evropë, kryesisht në



Gjermani, Itali dhe Britani. NATO-ja u themelua nga Shtetet e Bashkuara dhe 11 vende të tjera për ta kundërshtuar agresionin sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore. Sot aleanca i ka 32 anëtarë dhe përfshin shumë vende që dikur ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik ose nën sferën e ndikimit të tij. Trumpi pretendoi se vendet e tjera nuk do ta ndihmonin ShBA-në në rast nevojë, pavarësisht se hera e vetme kur

është aktivizuar neni 5 ishte kur u përcaktua se Shtetet e Bashkuara u sulmuan më 11 shtator 2001. “E dini cili është problemi më i madh që kam me NATO-n? Unë, singërisht, i njoh shumë mirë këta djem. Janë miqtë e mi. Por, nëse Shtetet e Bashkuara do të ishin në telashe dhe do t'u telefononim atyre dhe do të thoshim, ‘kemi një problem, Francë. Kemi një problem, disa të tjerë nuk do t'i përmend’. A mendoni se ata do të vijnë të na

mbrojnë? Do të duhej. Nuk jam aq i sigurt”, tha Trumpi. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, iu përgjigj Trumpit, duke thënë: “Ne jemi aleatë besnikë dhe të përkushtuar”. “Mendoj se kemi të drejtë të presim të njëjtën gjë”, tha Macroni, duke përmendur raste historike të bashkëpunimit ushtarak franko-amerikan që nga Lufta Revolucionare Amerikane. Franca dhe Amerika “gjithmonë kanë qenë pranë njëra-tjetrës”, theksoi ai. Më 5 mars Macroni tha se është i hapur për bisedime për shtrirjen e ombrellës bërthamore të Francës në vendet aleate të Parisit në kontinent, përballë agresionit rus dhe shqetësimeve rreth qëndrimit të ShBA-së për mbrojtjen e Evropës. Ndërkohë, Trumpi sugjeroi shfrytëzimin e përkushtimit të ShBA-së ndaj NATO-s si mjet presioni në luftën e tij tregtare, në përpjekjen për t'i shënjestruar ato që ai i ka cilësuar politika të padrejta tregtare nga vendet evropiane.

Raportuesi i Parlamentit Evropian i jep mbështetje anëtarësimit të Malit të Zi

BRUKSEL, 7 MARS - Raportuesi i Parlamentit Evropian për Malin e Zi, Marjan Sharec, deklaroi të enjten se mbështetja për anëtarësimin e Malit të Zi në BE është e lartë, por kjo nuk do të thotë, siç tha ai, se nuk ka probleme. Duke paraqitur një projekt-raport në Komisionin për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, Sharec përmendi si problem bllokimet e punës së parlamentit dhe mosfunksionimin e disa komunave lokale në Malin e Zi. Ai iu referua synimit të Podgoricës që Mali i Zi të bëhet anëtar i BE-së deri në fund të kësaj dekade, por paralajmëroi se Mali i Zi ka ende shumë punë për të bërë. Në këtë drejtim ai përmendi dështimin për ta hapur kapitullin 31 në negociatat e anëtarësimit. Ky është një kapitull që lidhet me politikën e jashtme, hapja e së cilës u pengua nga Kroacia.

“Duhet të theksoj se asnjë shtet anëtar nuk do të donte ta shihte këtë proces të anëtarësimit si një mënyrë për zgjidhjen e çështjeve dypalëshe. Ne duhet të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për t'i mbyllur të gjithë kapitujt”, tha Marjan Sharec. Duke reflektuar për vizitën e tij në Mal të Zi, ai konfirmoi në Parlamentin Evropian se të gjithë aktorët politikë kanë shprehur dëshirën e tyre që Mali i Zi të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian, “por ata kanë kuptime të ndryshme se si të arrihet kjo”. Parlamentin Evropian njeh angazhimin e fortë të Malit të Zi për pranimin në BE dhe konfirmon mbështetjen e tij të plotë për anëtarësimin e ardhshëm të vendit në BE. Projekt-raporti mirëpret përparimin pozitiv të Malit të Zi në zbatimin e reformave dhe masave të lidhura me BE-në,



mbështet kornizën kohore ambicioze dhe përpjekjet kolektive të aktorëve politikë, shoqërisë civile dhe qytetarëve, gjithashtu lavdëron Malin e Zi për përmbushjen e standardeve të përkohshme për kapitujt 23 dhe 24 dhe për marrjen e një IBAR pozitiv. Ky dokument u bënë thirrje të gjithë aktorëve politikë në vend që të mbeten të fokusuar në integrimin në BE dhe reformat e

nevojshme, duke theksuar nevojën për stabilitet politik, përkushtim dhe angazhim konstruktiv që kapërcen linjat partiake për të ecur drejt mbylljes së kapitujve shtesë. Gjithashtu, nënvizohet se reformat e miratuara duhet të zbatohen në mënyrë efektive për të siguruar progres real. Projekt-raporti i Parlamentit Evropian mirëpret përafrimin e vazhdueshëm dhe të plotë të Malit të Zi me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, duke përfshirë masat kufizuese kundër Rusisë. Vendi inkurajohet ta forcojë zbatimin e masave kufizuese dhe ta shmanjë anashkalimin e tyre. Dokumenti vë theks të veçantë në “ndërhyrjen e huaj me qëllim të keq” dhe përpjekjet destabilizuese, kërcënimet hibride dhe fushatat e dezinformimit nga aktorët e

vendeve të treta. Në seksionin mbi demokracinë dhe shtetin e së drejtës, drafti vëren me shqetësim bojkotet dhe bllokadat politike, si dhe ringjalljen e tensioneve dhe polarizimin etnik. Me këtë raport, Parlamenti Evropian do t'i bëjë thirrje Malit të Zi që ta harmonizojë plotësisht politikën e vizave me atë të BE-së, veçanërisht në lidhje me vendet që paraqesin rrezik për sigurinë. Në projekt-raportin e tij, Parlamenti Evropian mirëpret ligjet e reja të Malit të Zi për median dhe strategjinë e politikës së tij mediatike, këmbëngul në një politikë të tolerancës zero në lidhje me presionin ose ngacmimin e gazetarëve, përfshirë figurat publike, dhe thekson nevojën për monitorim efektiv të rasteve të mëparshme të sulmeve ndaj gazetarëve.

BE-ja miraton planin 150 miliardë euro për riarmatosje

BRUKSEL, 7 MARS - Liderët evropianë mbështetën planet për t'i rritur shpenzimet për mbrojtjen dhe për të vazhduar të qëndrojnë pranë Ukrainës në një botë të tronditur nga ndryshimi i politikave të ShBA-së nga Donald Trump. Samiti i mbrojtjes i Bashkimit Evropian në Bruksel u zhvillua mes frikës se Rusia, e inkurajuar nga lufta e saj në Ukrainë, mund të sulmojë një shtet të

BE-së dhe se Evropa nuk mund të mbështetet më te ShBA-ja për ndihmë. “Sot kemi treguar se Bashkimi Evropian po i përgjigjet sfidës, duke ndërtuar Evropën e mbrojtjes dhe duke qëndruar krah për krah me Ukrainën”, u tha gazetarëve drejtuesi i takimit, Antonio Costa. Liderët e BE-së përshëndetën propozimet e Komisionit Evropian këtë javë për t'u

dhënë atyre fleksibilitet fiskal për shpenzimet e mbrojtjes dhe për të marrë hua së bashku deri në 150 miliardë euro (160 miliardë dollarë) për t'u dhënë qeverive të BE-së për të shpenzuar për ushtritë e tyre. Në një deklaratë të përbashkët të miratuar nga të 27 vendet anëtare, liderët u bënë thirrje ministrave të tyre t'i shqyrtojnë urgjentisht këto propozime.



KOMBINIMET E MUNDSHME PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE TË KOSOVËS

Të gjitha votat e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë më në fund u numëruan. Ndonëse rezultati ka mbetur të certifikohet, pasqyra tani është më e qartë se kush i ka gjasat reale për ta formuar qeverinë e re. Kryeministri Kurti ka thënë të premten se është duke pritur certifikimin e rezultatit zgjedhor, ndërkaq liderët e opozitës, Memli Krasniqi dhe Ramush Haradinaj, kanë theksuar se opozita do ta bëjë qeverinë pas dështimit të Kurtit



PRISHTINË, 7 MARS - Në një anketë të publikuar ditë më parë në uebfaqen e Radios Evropa e Lirë janë pyetur lexuesit se kush, sipas parashikimeve të tyre, do ta formojë Qeverinë e re të Kosovës. Mes tri opsionesh - Lëvizja Vetëvendosje (LV) me minoritetet, Lëvizja Vetëvendosje me një parti opozitare, apo partitë opozitare - 60 për qind e pjesëmarrësve kanë votuar për të parin. Anketa si kjo, diskutime e kalkulime, na kanë parë sytë që tri javë gjithandej. LV-ja, që aktualisht është në pushtet dhe ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, është zotuar se do ta formojë sërish qeverinë. Udhëheqësi i saj, njëherësh kryeministër i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se po pret certifikimin e rezultateve, para se anëtarët e partisë së tij të ulen dhe ta shikojnë rrugën përpara: “Nuk ka ndryshuar situata që ne të kemi qëndrime të tjera sa iu përket kundërshtarëve tanë. Është bërë luftë hibride kundër qeverisë sonë dhe LV-së, dhe kemi dalë fitimtarë, dhe fitimtari duhet dhe do ta formojë qeverinë e re”.

Si mund ta bëjë LV-ja qeverinë e re?

Menjëherë pas publikimit të rezultateve preliminare, Kurti ka hedhur poshtë mundësinë e ndonjë koalicioni me partitë e mëdha shqiptare që janë në opozitë - Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK)

dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Edhe këto tri parti opozitare kanë thënë se nuk do të bashkëpunojnë me Kurtin. Me ligjet e Kosovës, brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve, presidentja e vendit duhet ta thërrasë mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës. Nëse zgjidhen kryetari dhe nënkryetarët, atëherë Vjosa Osmani duhet të kërkojë nga partia fituese, LV-ja në këtë rast, që ta propozojë mandatarin për formimin e qeverisë. Por, kjo parti duket se do t'i ketë 48 vende deputetësh, në Kuvendin e përbërë prej 120 sosh. Për ta formuar qeverinë, një mandatar i duhen të paktën 61 vota. Analistët politikë besojnë se Kurti llogarit në skenarin e formimit të qeverisë me minoritetet joserbe, që i kanë 10 vende, si dhe në lëvizjet që mund t'i bëjnë disa deputetë të opozitës aktuale “për pozita ministrore”. Udhëheqësi i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, që është në koalicion me AAK-në, ka thënë hapur se nuk ka “vija të kuqe” përballë koalicioneve të mundshme, qoftë me LV-në, qoftë me partitë që aktualisht janë në opozitë. Por, për politologun Dritëro Arifi, Kosovës nuk i duhet një qeveri “e brishtë” në situatën aktuale gjeopolitike në botë. “Një parti e vetme, si Vetëvendosje, me një koalicion kaq të vogël dhe të brishtë, do ta ketë të pamundur t'i realizojë kërkesat që mund të vijnë nga partnerët ndërkombëtarë”, thotë Arifi për Radion Evropa e Lirë.

A mund të bëhet një qeveri PDK-LDK-AAK?

I pyetur për kërkesat eventuale, Arifi vlerëson se mund të mos bëhet më fjalë vetëm për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe: “Çka nëse kërkohet diçka më shumë, sa jemi të gatshëm të lëvizim në këto ndryshime të mëdha globale? Mund të kërkohej shumë gjëra, nuk po aludojmë shumë, por po e marrim vetëm një: çfarë nëse kërkohet ndryshim i kufirit? Çfarë jemi të gatshëm ta bëjmë dhe si do ta bëjmë? Ky është mëkati më i madh, që një shoqëri e tërë nuk ka përgjigje”. Në rast se partia fituese nuk arrin ta formojë qeverinë brenda dy javësh, atëherë presidentja detyrohet të mandatojë atë parti ose grup që e bind se mund ta formojë atë. Për Arifin, edhe nëse kjo nënkupton koalicion mes tri partive të mëdha shqiptare, PDK-LDK-AAK, pamja është sërish e zbehtë, për faktin se nuk garantohej stabilitet.

Cili kombinim do të mund të funksiononte?

Arifi mendon se një koalicion mes LV-së dhe PDK-së do të ishte më i miri për Kosovën, sepse ashtu, sipas tij, do të mund të tejkalohet edhe kriza për pozitën e presidentit, pasi Osmanit t'i skadojë mandati vitin tjetër. I pyetur se sa ka mundësi të funksionojë një koalicion i tillë, se sa janë afër në ideologji këto parti, Arifi beson se asnjëri subjekt politik në Kosovë nuk ka dallime në këtë

drejtim, dhe se që të gjithë e kanë thuar se të njëjtin koncept: “Nëse i shikoni vetëm debatet dhe fjalimet, gjithçka në Kosovë sillet rreth sektorit publik, rritjes së pagave. Botëkuptimi i politikëbërjes është shumë i ngushtë. Nuk kanë dallim të madh”. Megjithatë, sipas Arifit, një koalicion LV-PDK do të mund të funksiononte, nëse partitë fokusohen në 6-7 prioritete, në mënyrë që rezultati të jetë “pozitiv për shoqërinë dhe për shtetin”. Rëndësinë e stabilitetit në Kosovë e ka përmendur edhe faktori ndërkombëtar. Më së voni, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë që Kosova duhet të ketë një qeveri stabile, teksa ka pohuar se aleanca ushtarake do të punojë me këdo që do ta udhëheqë Kosovën.

Krasniqi: Kushdo që bëhet kryeministër të nesërmen duhet të shkojë në Uashington

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka deklaruar se kushdo që bëhet kryeministër i Kosovës vizitën e parë jashtë vendit duhet të bëjë në Uashington. Ai ka bërë me dije se situata është shumë serioze dhe se kryeministri i ardhshëm këtë vizitë duhet ta realizojë një ditë pasi ta marrë mandatin. Në emisionin “Click” në RTV21, ai ka thënë se kjo vizitë duhet të bëhet për t'i realizuar takimet më të larta në atje. “Unë e them në mënyrë figurative që ai që bëhet kryeministër shpresoj që të jetë

Bedri Hazma, të nesërmen duhet me ble një biletë për Uashington edhe me lyp takime të të gjitha niveleve, për të diskutuar se cila është rruga përpara”, ka thënë Krasniqi. I pari i PDK-së ka treguar se nuk është i interesuar të marrë pozita ekzekutive nëse qeverinë e formon PDK-ja. Sipas tij, ai do të qëndrojë në krye të partisë për t'i vazhduar reformat. “Do t'i vazhdoj reformat në parti. Nëse z. Hamza bëhet kryeministër, do të jetë një lehtësim i madh, sepse atëherë e di se qeveria është në drejtimin e duhur, dhe më mbetet me shumë kohë të merrem me partinë”, është shprehur ai.

Haradinaj thotë se qeverinë duhet ta formojë opozita

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka përjashtuar çdo mundësi të bashkëpunimit me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e qeverisë. Ai ka thënë për “KosovaPress” se qeverinë duhet ta formojë opozita dhe, sipas tij, ka komunikim për këtë. “Besoj se veç shihet se shumicën e ka opozita. Kuptohet, pas afateve kushtetuese, opozita mund ta krijojë qeverinë. Besoj kjo është ajo që na takon neve si opozitarë, që të bashkohemi dhe të krijojmë qeverinë nga opozita. Ka komunikim të ndërsjellë [me opozitën], nuk ka ndonjë avancim konkret, për shkak se janë edhe afatet kushtetuese, por besoj ka gatishmëri që të ecim”, ka thënë Haradinaj.



KOSOVA PA ASNJË KONTRATË LOBIMI NË SHBA

Si rrallëherë në historinë e pasluftës së Kosovës, institucionet shtetërore, aktualisht, nuk kanë asnjë kontratë aktive lobimi në Shtetet e Bashkuara. Njohësit e politikave vendore dhe ndërkombëtare paralajmërojnë se kjo rrezikon ta lërë Kosovën nën hije dhe “pa një vend në tavolinë”

PRISHTINE, 7 MARS - Që nga viti 1992 Kosova ka pasur pothuajse vazhdimisht kompani lobimi, të kontraktuara për ta shtyrë përpara agjendën dhe interesat e saj në ShBA. Për momentin asnjë kontratë e tillë nuk listohet aktive në uebfaqen e Aktit të Regjistrimit të Agjentëve të Huaj (FARA) të Departamentit amerikan të Drejtësisë. Deri vitin e kaluar Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) e Kosovës i ka pasur dy marrëveshje të tilla, por ato tani kanë skaduar. Edhe pse ministrja e Jashtme, Donika Gërvalla, ka thënë se do të shqyrtohet vazhdimi i atyre kontratave njëvjeçare, një gjë e tillë nuk është bërë. Analistja politike Donika Emini paralajmëron se institucionet e Kosovës nuk duhet të mbështeten vetëm në diplomacinë konvencionale - pra përmes ambasadave e konsullatave - veçanërisht në

kohën kur, siç thotë, “tensionet gjeopolitike po përshkallëzohen dhe përçarjet transatlantike po thellohen”. “Kosova kërkon e pret mbështetje politike nga ShBA-ja pa ofruar asgjë në këmbim. Uashingtoni nuk është një vend ku vlerësohesh vetëm për vullnetin e mirë; është një fushëbetejë e influencës, ku lobimi, partneritetet strategjike dhe aftësia diplomatike përcaktojnë se kush zë vend në tavolinë”, thotë për Radion Evropa e Lirë Emini nga Grupi Këshillëdhënës në Evropë për Politikë të Ballkanit. Dhe, kush po zë vend në tavolinë? Serbia, thotë Emini. Ajo argumenton se, përderisa Kosova nuk po arrin ta paraqesë veten si “kontribuese e vlefshme në rendin e ri global”, Serbia “është pozicionuar si një aktore transaksionale, duke ofruar bashkëpunim ekonomik dhe duke shfrytëzuar burimet e saj natyrore”. “Nëse Kosova nuk

modernizon qasjen e saj diplomatike, rrezikon të bëhet një lojtare dytësore në politikën rajonale, me fatin e saj të diktuar gjithnjë e më shumë nga të tjerët, jo vetëm nga ShBA-ja, por edhe nga rivalët e saj rajonalë, të cilët janë shumë më agresivë, strategjikë dhe transaksionalë në angazhimin e tyre me Uashingtonin”, shton Emini. Aktualisht, institucionet shtetërore të Serbisë kanë pesë kontrata lobimi aktive në ShBA. Institucionet e Kosovës s’kanë treguar nëse do të nënshkruhen kontrata të tilla tani, pas ndërrimit të administratës në ShBA.

Si llobojnë vendet e rajonit?

Institucionet shtetërore të Serbisë - Qeveria, Republika, Ambasada dhe Oda Ekonomike - kanë pesë kontrata me firma amerikane të lobimit. Njëra prej tyre është lidhur këtë vit me kompaninë “BlackSummit Capital”, për ta ndihmuar Serbinë në raport me “sanksionet e vendosura së voni ndaj sektorit të energjisë”. Vlera e kësaj kontrate nuk është specifikuar, ndërsa Serbia do ta paguajë 65 mijë dollarë në muaj kompaninë Valcour dhe 60 mijë

dollarë në muaj kompaninë “KARV Commnications”. Ambasada e Serbisë do ta paguajë 50 mijë dollarë në muaj kompaninë BGR Group dhe Oda Ekonomike do ta paguajë 840 mijë dollarë për një vit kompaninë “Yorktown Solutions”. Nga Bosnjë-Hercegovina, ndërkaq, janë gjashtë kontrata - të gjitha nga entiteti i Republikës Sërsпка (RS). Njëra prej tyre - me kompaninë “Zell & Associates International Advocates” - është lidhur këtë vit. Në kontratën e publikuar në FARA është censuruar vlera e saj, por tregohet se, mes të tjerash, synohet heqja e sanksioneve ndaj presidentit të RS-së, Millorad Dodik. Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi nuk kanë asnjë kontratë lobimi, ndërsa nga Shqipëria kontratë “pro bono” ka lidhur vetëm politikani Lulzim Basha. Pak pasi Kosova ka mbetur pa asnjë kontratë lobimi në ShBA, atje është ndërruar administrata, në krye të së cilës është presidenti republikan, Donald Trump. Deri më tani komunikimi i vetëm zyrtar i tij me Kosovën ka qenë një letër urimi për përvjetorin e pavarësisë së Kosovës dërguar presidentes Vjosa Osmani. Ajo letër ka ardhur pas disa kritikave që i dërguari i Trumpit për

misione të veçanta, Richard Grenell, i ka bërë ndaj qeverisë së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Grenelli ka thënë se ShBA-së i duhen partnerë të besueshëm në Ballkan, ndërsa qeveria e Kurtit nuk është e tillë. Grenelli ka thënë, po ashtu, se marrëdhëniet mes dy vendeve nuk kanë qenë kurrë në pikë më të ulët. Pikërisht shkak i këtyre tensioneve në raportet mes Qeverisë së Kosovës dhe zyrtarëve amerikanë, ambasadori i parë i Kosovës në ShBA, Avni Spahiu, thotë se kontraktimi i lobuesve në ShBA, do të ishte kyç. “Duhet të them se nëse ne i krijojmë hapësirë të zbrazët Serbisë për të lobuar, atëherë kjo është në dëm të tonë. Ne nuk duhet të lëmë asnjë hapësirë të zbrazët në këtë kohë, kur na duhet më së shumti mbështetja e ShBA-së”, thotë Spahiu. Gjatë mandatit të parë të Trumpit si president, në periudhën 2017-2021 Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar një marrëveshje në Uashington për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike. Por, ajo marrëveshje nuk është zbatuar në plotësi në terren, njëjtë si shumë nga marrëveshjet e nënshkruara në mes të Kosovës dhe Serbisë në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi

Shefi i NATO-s viziton Kosovën më 11 mars

PRISHTINË, 7 MARS - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, do ta vizitojë Kosovën më 11 mars, për herë të parë që kur ka marrë këtë pozitë. Lajmin e ka dhënë NATO-ja përmes një

komunikate për medie. “Më 11 mars 2025 Këshilli i Atlantikut të Veriut, me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, z. Mark Rutte, dhe zëvendëssekretaren e përgjithshme të NATO-s, znj.

Radmila Shekerinska, do t vizitojë KFOR-in, misionin e udhëhequr nga NATO në Kosovë, dhe ekipin e këshilltarëve dhe lidhësve të NATO-s (NALT)”, është thënë në njoftimin e NATO-

s. Sipas këtij njoftimi, sekretari i përgjithshëm do të takohet edhe me presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe përfaqësues ndërkombëtarë në Kosovë.



DEBATI NË PRISHTINË: QEVERIA E KOSOVËS DUHET TË BËJË MË SHUMË PËR INTEGRIMIN E SERBËVE, POR EDHE VETË KOMUNITETI



PRISHTINË, 7 MARS - Gjetja e mënyrave për kthimin e serbëve në Policinë e Kosovës dhe ndërtimi i besimit, tërheqja e njësive speciale të Policisë nga veriu i Kosovës, njohja e dokumenteve të lëshuara nga organet e Serbisë si dhe vendimet e gjykatave serbe, janë disa nga rekomandimet që organizata joqeveritare Qendra për Veprime Afirmative Sociale (CASA) i ka drejtuar Qeverisë së Kosovës për shqyrtim. Këto rekomandime janë pjesë e një hulumtimi në kuadër të projektit “Reflektimi i interesave të serbëve të Kosovës për të formuluar propozime të

politikave për një Kosovë multi-etnike”, i cili është mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, me qëllim integrimin e serbëve të Kosovës. Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, vlerësoi se anëtarët e komunitetit serb “po përfetojnë presion” nga Beogradi zyrtar kur bëhet fjalë për integrimin në shoqërinë e Kosovës, dhe shprehu shpresën se me angazhim më të madh të Qeverisë së Kosovës, jeta e tyre mund të “bëhet më e lehtë”. “Që ata të ndihen të mirëpritur,

që [Kosova] është shtëpia e tyre tani, që është shtëpia ku duan të jenë. Besoj se komuniteti [serb] mund të bëjë shumë, veçanërisht kur ka mjete, ide dhe propozime që mund ta përmirësojnë bashkëpunimin. Ky studim kontribuon në këtë”, tha Hargreaves. Të dhënat për këtë hulumtim janë mbledhur, ndër të tjera, përmes pyetësorëve të cilëve iu përgjigjën 303 pjesëmarrës, deklarimeve anonime dhe forumeve publike që mbledhën përfaqësues të serbëve nga komunat me shumicë serbe, në veri dhe jug të lumit Ibër.

Evropian në Bruksel. Tani Kosova pret të ketë qeveri të re, pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, të cilat i ka fituar partia në pushtet e kryeministrit Albin Kurti - Lëvizja Vetëvendosje - por pa siguruar shumicën e nevojshme prej 61 deputetësh për ta formuluar e vetme qeverinë. Emini shpreson që qeveria e re ta ndryshojë qasjen ndaj ShBA-së. Ajo e cilëson këtë si “çështje mbijetese diplomatike”. “Nëse Kosova nuk merr masa urgjente, rrezikon të mbetet në hije në Uashington, e paaftë për të kundërshtuar ndikimin në rritje të Serbisë dhe e anashkaluar në qarqet kyçe të vendimmarjes”, paralajmëron Emini. Ajo thotë se fakti që Kosova nuk i ka dhënë rëndësi ShBA-së, reflektohet edhe në numrin e vogël të diplomatëve të angazhuar në ambasadë, në krahasim me Serbinë. Të pyetur nga Radio Evropa e Lirë nëse do të ketë ndonjë kontratë të re lobimi, nga MPJD-ja kanë thënë se nuk mund t'i komentojnë kontratat e lobimit pasi që “ato janë konfidenciale”. Këto kontrata, megjithatë,

publikohen të plota e të pacensuruara në ueb-faqen e FARA-s, pasi që ligjet në ShBA i detyrojnë lobistët t'i raportojnë të gjitha aktivitetet e ndërmarrja gjatë kohës sa janë të kontraktuar nga “agjentë të huaj”. Nga raportet në këtë ueb-faqe, REL-i ka raportuar në të kaluarën për punën e dy shqiptarëve të kontraktuar në vitin 2023 për lobim njëvjeçar nga MPJD-ja, Avni Mustafaj dhe Afërdita Rakipi. Shumë prej shpenzimeve gjatë gjashtëmujorit të parë të atyre kontratave janë raportuar për dreka dhe darka pune në Kosovë, ndonëse me to është paraparë ofrimi i këshillave dhe përfaqësimit të MPJD-së “brenda Shteteve të Bashkuara”. Ndërsa, në gjashtëmujorin e dytë, ata kanë raportuar punë pothuajse identike - duke kontaktuar të njëjtit persona, në të njëjtat ditë, me të njëjtën përmbajtje të emailleve - edhe pse kontratat e tyre kanë qenë individuale. Megjithëse pa lobues të kontraktuar tash për tash, MPJD-ja thotë se është “e përkushtuar

për ndërtimin dhe forcimin e marrëdhënieve të qëndrueshme, strategjike dhe afatgjate me Shtetet e Bashkuara të Amerikës”. Nga kjo ministri thonë se këtë synim do ta arrijnë përmes “instrumenteve të ndryshme të diplomacisë, duke përfshirë edhe kontratat e lobimit”. Konferenca Kombëtare amerikane e Legjislaturave Shtetërore e përkufizon lobimin si “përpjekje për të ndikuar në veprimet e qeverisë përmes komunikimit me shkrim ose me gojë”. Pra, përmes lobimit, shtete të huaja mund të tentojnë në mënyrë të ligjshme të ndikojnë në politikën e ShBA-së. “Në Uashington lobimi nuk është luks. Është domosdoshmëri. Është mënyra se si vendet e vogla e forcojnë zërin e tyre në korridoret me fuqi politike”, thotë Emini. Në të kaluarën edhe institucione të tjera shtetërore, si Presidenca dhe Kryeministria e Kosovës, kanë lidhur kontrata lobimi në ShBA. Një javë më parë, REL-i i ka pyetur të dyja këto institucione se

pse nuk kanë aktualisht kontrata lobimi, por nuk ka marrë përgjigje. Për miliona eurot e shpenzuara ndër vite, në Kosovë kanë qenë të kontraktuara kompani të njohura amerikane për lobim, si “Podesta Group” dhe “Ballard Partners”. Njëra kontratë me “Podesta Group” është nënshkruar gjatë kohës sa Avni Spahiu ka qenë ambasador i Kosovës në ShBA. Spahiu, i cili ka shërbyer si ambasadori i Kosovës në Uashington në vitet 2008-2012, thotë se edhe në atë kohë, kur Kosova ka gëzuar përkrahje të madhe nga ShBA-ja, lobimi, prapëseprapë, ka pasur efekt. “Mirëpo, tani mendoj se duhet të ketë përpjekje të re për t'i rikrijuar këto raporte, në kuptim të përforsimit dhe përmirësimit - edhe për shkak të ndryshimeve në Shtëpinë e Bardhë, por edhe për shkak të disa gjërave që kanë ndodhur në raportet mes dy vendeve”, thotë Spahiu. Ai e përmend lobimin në vitet '90 si histori suksesi të lobit shqiptar në ShBA dhe thotë se sërish duhet të ketë një angazhim të tillë për “kthimin e besimit të

plotë të ShBA-së ndaj Kosovës”. “Kjo është me rëndësi dhe mendoj se duhet të bëhet sa më parë. Ndonëse nuk është i mjaftueshëm vetëm angazhimi i ndonjë kompanie, por duhet edhe një diplomaci më proaktive e Kosovës, një angazhim edhe i ambasadës dhe i të gjitha forcave diplomatike që kemi aktualisht”, shton Spahiu. Për Eminin është shqetësuese që Kosova, edhe 17 vjet pas shpalljes së pavarësisë, mbështetet në Uashington për garanci sigurie dhe përkrahje politike si në vitin 1990 dhe në fillim të viteve 2000. “Ndryshe nga viti 2008, kur mbështetja amerikane për pavarësinë e Kosovës ishte e palëkundur, sot politika e jashtme drejtohet nga ajo që një vend mund të ofrojë, jo vetëm nga ajo që kërkon”, thotë Emini. Ajo i ka të qarta kërkesat për institucionet e Kosovës: investoni në lobim, zgjeroni prezencën diplomatike në Uashington, krijoni vizion të qartë për atë që Kosova mund të ofrojë si aleate dhe ringjallni angazhimin me diasporën.

Vendos Apeli, mbetet në fuqi aktakuza ndaj Nagip Krasniqit

PRISHTINË, 7 MARS - Gjykata e Apelit e ka refuzuar të pabazuar ankesën e mbrojtësit të ish-kryeshefit të KEK-ut, Nagip Krasniqit, i cili akuzohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Me këtë vendim është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë i 5 dhjetorit të vitit të kaluar. “Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PS. nr. 67/24, të datës 05.12.2024, i ka

refuzuar si të pabazuara kërkesën për hedhjen të aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave, të paraqitura nga mbrojtësit e të pandehurit N. K., kundër aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS. nr. 40/2023, të datës 19.08.2024, në të cilën i pandehuri i lartcekur akuzohet për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në vazhdimësi, nga neni 414 paragrafi 2 lidhur

me nenin 77 të KPRK. Gjykata e Apelit, ka vlerësuar aktvendimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore, por edhe sipas detyrës zyrtare në drejtim të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe ka konstatuar se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale apo shkelje tjera të cilat do ta kushtëzonin anulimin e aktvendimit”, është thënë në vendimin e Gjykatës së Apelit.



LIDERËT SHTETËRORË DHE PARTIAKË UROJNË PËR 7 MARS: MËSUESIT, SHTYLLA KRYESORE NË FORMËSIMIN E BREZAVE

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 MARS - Me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, liderët shtetërorë dhe ata partiakë i kanë uruar mësuesit për këtë ditë.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, në urimin e saj ka thënë se më 7 mars "kujtojmë themelimin e shkollës së parë shqipe në Korçë më 1887, një akt i guximshëm i patriotëve tanë, që e kuptuan se pa gjuhë dhe dije, nuk ka as komb të suksesshëm".

"Sot shkolla është më shumë se një institucion mësimor - është fortësia ku ndërtohet e ardhmja. Mësuesit mbeten shtylla e shoqërisë dhe ata që

formësojnë mendjet dhe zemrat e kombit. Në këtë ditë, nderojmë të gjithë mësuesit - ata që na mësuan shkronjat e para dhe ata që ende mësojnë brezat e rinj. Respekt, mirënjohje dhe përlulesi para misionit të tyre fisnik! Gëzuar 7 Marsin, Ditën e Mësuesve!", thuhet në urimin e Osmanit.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se sot shënojmë një nga ditët më të rëndësishme të kalendarit tonë, që na kujton themelin e çdo suksesi si shoqëri: 7 Marsin, Ditën e Mësuesit. Ai ka thënë se mësimdhënësit tanë nuk kanë qenë vetëm edukatorë, por edhe patriotë, udhërrëfyes dhe burim frymëzimi për familje dhe breza të tërë: ashtu siç ishte Shaban

Jashari. "Ata kanë qenë shtylla mbi të cilën është mbështetur qëndrueshmëria jonë kombëtare, duke u bërë pishtarë të dijes edhe në kohët më të vështira. Në momentet më të errëta për vendin, kur shkolla nuk ishte thjesht një institucion, por një bastion i rezistencës dhe shpresës, ata sakrifikuan gjithçka për një të ardhme më të mirë. Sot, ndërsa vazhdojnë të edukojnë brezat e rinj, ata mbeten zemra e shoqërisë dhe garancia për një Kosovë më të zhvilluar. Me respekt dhe mirënjohje të thellë për çdo mësues që ndriçon rrugën tonë - Gëzuar Ditën e Mësuesit!", ka thënë Krasniqi në urimin e tij. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku,

me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ka shprehur mirënjohje dhe falënderime për të gjithë mësuesit e mësueset, të cilët kanë kontribuar dhe kontribuojnë në edukimin dhe përparimin e shoqërisë sonë. "Të gjithë mësimdhënësve, urime 7 marsi, Dita e Mësuesit! Në këtë ditë dhe jo vetëm, kujtojmë rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të mësimdhënësve, në detyrën dhe misionin e tyre fisnik për edukimin dhe arsimimin e brezave. Dita e Mësuesit na kujton rëndësinë që kanë mësimdhënësit në ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të përparuar dhe të qëndrueshme. Të gjithë ata, me pasion, përkushtim dhe angazhim të

palëkundur, kontribuojnë në zhvillimin intelektual dhe moral të brezave të rinj, duke ofruar mundësi për një të ardhme më të mirë për të gjithë ne. Angazhimi i mësuesve dhe mësueseve, është gurthemel në ndërtimin e shtetit tonë dhe arsimimin e brezit që do të udhëheqë vendin në të ardhmen. Prandaj, trajtimi dinjitoz i mësimdhënësve, mbetet prioritet për Lidhjen Demokratike të Kosovës", ka thënë ai.

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se gjatë gjithë historisë sonë, mësuesit kanë qenë shtylla kryesore në formësimin e brezave, duke mbjellë dijen dhe ndërgjegjen kombëtare.



BE-ja THOTË SE SERBIA PO E SHKEL MARRËVESHJEN ME KOSOVËN ME SJELLJEN E SAJ NË KIE

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 MARS - Bashkimi Evropian (BE) ka thënë të premtën se Serbia, me sjelljen e saj në Këshillin e Evropës, është duke e shkelur Marrëveshjen e Ohrit të vitit 2023, në të cilën, mes të tjerash, Beogradit i kërkohet të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare.

Kosova hasi edhe në një pengesë tjetër gjatë kësaj jave në Këshillin e Evropës (KIE), pasi kërkesa e saj për të qenë mysafire speciale në Komitetin për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të KIE-së, u hoq nga rendi i ditës të mërkurën.

Serbia, përmes delegacionit të



vet në këtë Komitet, por edhe përmes kryetares së Kuvendit, Ana Bernabiq, u krenua për këtë arritje, duke e quajtur fitore të madhe të Serbisë në mbrojtjen e

interesave kombëtare. I pyetur për këtë, një zëdhënës i BE-së tha të premtën se Serbia qartazi po i shkel detyrimet e saj nga Marrëveshja e Ohrit, e

arritur mes saj dhe Kosovës më 2023. "Sjellja e Serbisë në Këshillin e Evropës është një shkelje e qartë e obligimeve të Serbisë nga Marrëveshja e Ohrit", thotë zëdhënësi i BE-së, duke nënvizuar se ky obligim përmendet në nenin 4 të Marrëveshjes, ku flitet për moskundërshtimin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Serbia, në disa raste në të kaluarën, ka lobuar kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, ndonëse Marrëveshja e arritur me lehtësimin e Bashkimit Evropian qartë thotë se ajo nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. Marrëveshja nuk është nënshkruar, por BE-ja ngul këmbë se ajo është ligjërish e

detyrueshme për palët dhe duhet të zbatohet në tërësi.

Kosova dështoi të anëtarësohet në Këshillin e Evropës në fillim të vitit 2024 për shkak se u kushtëzua me krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Edhe Asociacioni është obligim për Kosovën nga kjo Marrëveshje. Vitin e kaluar Serbia kishte formuar grup punues për koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve shtetërore kundër pranimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Këshilli i Evropës është organizatë lidere në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Anëtarësimi eventual do t'i ndihmonte Kosovës, mes të tjerash, në fushën e sundimit të ligjit dhe luftimin e korrupsionit.

Gjatë vitit 2024 u kryen mbi 17 mijë lindje në ShSKUK

PRISHTINË, 7 MARS - Gjatë vitit 2024 në tërë Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës janë kryer 17 mijë e 495 lindje.

Nga statistikat e përgjithshme, në QKUK ka pasur 7 901 lindje apo 45 %, si dhe 9 594 lindje në spitalet e përgjithshme apo 55 %.

Nga numri i përgjithshëm i lindjeve, 6 708 janë kryer me operacion (Cesarean Section) apo 39 %. Në QKUK ka pasur 3 121

lindje me operacion apo 41 % e fëmijëve të lindur, në spitalet e përgjithshme 3 587, 38 % e fëmijëve të lindur.



Diplomoi gjenerata e 45-të e zyrtarëve korrektues

PRISHTINË, 7 MARS - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, dhe zëvendësministrin Blerim Sallahu, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së 45-të të Zyrtarëve Korrektues. Në këtë ditë të veçantë kryeministri Kurti tha se sot diplomimi i 111 kadetëve është dëshmi e angazhimit tonë për një sistem korrektues të fuqishëm, të sigurt dhe të drejtë, përveç se thjesht një ceremoni. “Me diplomimin e gjeneratës së 45-të të zyrtarëve korrektues ne forcojmë edhe më shumë sistemin tonë korrektues dhe i shtojmë radhët me profesionistë të përgatitur. Ata e ato do të jenë garantues të drejtësisë dhe rregullit në institucionet tona korrektuese”, u shpreh ai.

Kryeministri shtoi se puna në sistemin korrektues është e domosdoshme, me ç'rast përmes reformave të ndërmarra gjatë viteve të fundit janë bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e sigurisë, rehabilitimin e të dënuarve, përmirësimin e kushteve të punës për zyrtarët korrektues, investimin në infrastrukturë, forcimin e njësive të specializuara dhe zgjerimin e programeve rehabilituese për të burgosurit. “Disa nga rezultatet e përmendura përfshijnë edhe



rritjen e rasteve të parandaluara të kontrabandës, zgjerimin e programeve rehabilituese, rritjen e sigurisë brenda institucioneve korrektuese falë fuqizimit të Njesisë së Inteligjencës, Njesisë Ekonomike dhe Njesisë për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve, mundësi të reja punësimi për të burgosurit në kompani publike e ndërmarrje private, progres në barazinë

gjinore duke rritur numrin e grave në Shërbimin Korrektues, si dhe respektimin e të drejtave të të burgosurve, përfshirë rritjen e ditëve të lejuara për vikend në shtëpi dhe lejimin e pakove ushqimore”, thuhet në njoftimin e bërë nga zyra e kryeministrit. Ndërkaq, duke iu drejtuar të diplomuarve, kryeministri shprehu se, përveçse ta mbajnë rendin, ata duhet edhe të

kontribuojnë në rehabilitimin dhe risocializimin e atyre që janë në duart e sistemit korrektues. Për këtë arsye kërkohet prej tyre profesionalizëm, etikë dhe angazhim i lartë. “Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë ta mbështesë fuqizimin e Shërbimit Korrektues dhe të gjithë zyrtarëve që japin kontribut në këtë fushë. Siguria, drejtësia

dhe sundimi i ligjit janë shtyllat e një shteti të fortë, të qëndrueshëm e demokratik, dhe ju, duke nisur që nga sot, jeni pjesë e kësaj shtylle kaq të rëndësishme”, përmbylli fjalën kryeministri, duke u uruar të diplomuarve suksese në rrugëtimin profesional dhe duke i falënderuar për angazhimin e marrë për të shërbyer në vendin tonë me nder dhe dinjitet.

Zafa: Kosova më afër zgjedhjeve të jashtëzakonshme sesa formimit të qeverisë



PRISHTINË, 7 MARS - Kandidati për deputet i koalicionit AAK-Nisma, Zafir Berisha, ka thënë se Kosova është më afër zgjedhjeve të jashtëzakonshme sesa formimit të qeverisë. “Pak orë pasi u dha rezultati preliminar për zgjedhjet e 9 shkurtit pata shkruar: ‘Të hipnotizuar nga një skizofren, një grumbull ‘hajvanësh’ me 9 shkurt e humbën mundësin që të fitoj

Kosova dhe e futën vendin me një udhëkryq!’. Sot, është mëse e qartë se ndryshimet ligjore për zgjedhjet e parlamentare kanë bërë një regres në këtë proces demokratik, ku me të drejtë zgjedhjet e 9 shkurtit mund të llogariten si zgjedhje më të manipuluar dhe korruptuara që nga pas lufta, duke ja kaluar për të keq edhe zgjedhjeve të 2010, për të cilat kemi menduar

se do të mbeten një histori e keqe dhe e papërsëritur”, ka shkruar Berisha në “Facebook”. Ai ka thënë se zgjedhjet e 9 shkurtit, përveçse kanë prodhuar lëndë për prokurorin e shtetit, ato kanë bunkerizuar partitë në pozicione të tyre, nga ku, sipas tij, Kosova është më afër zgjedhjeve të shërbyer në vendin tonë me nder dhe dinjitet.

Përparim Rama emëron Florian Dushin nënkryetar të Prishtinës

PRISHTINË, 7 MARS - Florian Dushi do të jetë nënkryetar i Prishtinës. Ai është emëruar nga kryetari Përparim Rama, pasi nënkryetari i deritashëm, Alban Zogaj, fitoi votat për deputet. “Me kënaqësi njoftoj se Florian Dushi do të jetë nënkryetar i

Komunës së Prishtinës. Kontributi i tij i jashtëzakonshëm ka qenë i padiskutueshëm dhe jam i bindur se do të vazhdojë të jetë i tillë edhe në pozitën e re, ku përfshihen edhe sektorët kyç si Inspektorati, Shërbimet Publike, Zyra Ligjore dhe

Administrata. Floriani do të fillojë punën, menjëherë pas përmbylljes së procesit zgjedhor qendror. Ky vendim është pjesë e strategjisë tonë për të forcuar ekipet tona dhe për të siguruar një të ardhme më të mirë për Kryeqytetin”, ka njoftuar Rama.



Rinisja nga zeroja: Shumë grave u mohohet pasuria e përbashkët gjatë divorcit

PRISHTINË, 7 MARS - Në një banesë njëdhomëshe në Prishtinë ka disa muaj që Jehona jeton me qira. Ajo mban dy punë për t'i mbuluar shpenzimet e saj dhe të djalit të vogël, të cilin po e rrit vetë, pas ndarjes nga ish-bashkëshorti. Jehona - emër i vendosur nga redaksia e Radios Evropa e Lirë (REL) për t'ia ruajtur anonimitetin - vendosi ta riniste jetën e saj, pasi raportoi dhunën në familje, që thotë se e kishte përjetuar për disa vjet radhazi. "E kam nisur nga zeroja, se unë trashëgimi prej babait nuk kam. Por, s'e kam problem. Vetëm ta kem shëndetin, se punoj", thotë Jehona.

Ajo pretendon se ish-bashkëshorti i saj qëndron mjaft mirë financiarisht. Përveç shtëpisë ku jeton, ajo thotë se ish-bashkëshorti ka blerë edhe banesë në Fushë-Kosovë, gjatë kohës sa kanë qenë të martuar. "Kurrë nuk më ka treguar për asgjë, i ka mbajtur gjërat shumë të fshehura. Ka blerë banesë, ka veturë. I ka transferuar të gjitha në emër të vëllait, të babait, që të mos i ndajë me mua", thotë Jehona. "Ai mund të më ndihmonte, sepse i ka kushtet, punon... Por, ai punon në të zezën, i merr paratë kesh, nuk i deklaron", pretendon ajo. Ligji për Familjen në Kosovë e cilëson pasurinë e krijuar gjatë një martese si pasuri të përbashkët që, në rast divorci, duhet të ndahet në mënyrë të barabartë mes partnerëve. Por, kjo e drejtë e përcaktuar me ligj nuk u njihet, sikurse Jehonës, edhe shumë grave të tjera, thotë Melisa Kadolli, monitoruese e gjykatave në Rrjetin e Grave të Kosovës (RRGK). Ajo tregon për REL-in se vetë RRGK-ja, që ofron asistencë ligjore për gra, ka hasur në raste kur grave u është mohuar kjo e drejtë, "për shkak të fshehjes së pasurisë nga ish-bashkëshortët", të cilët e lënë atë në emër të ndonjë të afërmi të tyre. "Shpesh gjykatat mbështeten kryesisht në prova të sjella nga palët, duke mos ndërmarrë vetë veprime proaktive për të hetuar dhe siguruar prova", thotë Kadolli. Arrita Rezniciq nga Instituti i Kosovës për Drejtësi



paralajmëron se një gjë e tillë përbën vepër penale, që "varësisht nga rrethanat, mund të jetë e dënueshme me deri në tetë vjet burgim". Meqë rastet e ndarjes së pasurisë së përbashkët i takojnë fushës së drejtësisë civile, Rezniciq sqaron se vetë palët kanë për detyrë të paraqesin fakte dhe prova për kërkesat e tyre. "Pra, gjykata është e lidhur për kërkesën e palës dhe nuk mund të vendosë përtej asaj. Kjo do të thotë se, në momentin kur pala vetë ose përmes përfaqësuesit e parashtron kërkesën e vet, duhet t'i qartësojë dhe specifikojë të gjitha elementet e nevojshme", thotë ajo. Tregu joformal i punës në Kosovë e vështirëson procesin e ndarjes së pasurisë. Sipas një raporti të vitit të kaluar të RRGK-së, rreth 42 për qind e kosovarëve nuk marrin kontrata pune dhe nuk regjistrohen si punëtorë në kompanitë ku punojnë. Edhe gratë janë të përfshira në tregun joformal, që do të thotë se edhe ato, potencialisht, mund të kenë pasuri të padeklaruar, të cilën mund ta fshehin gjatë procesit të divorcit. Megjithatë, mbi 80 për qind e grave në Kosovë nuk janë pjesë e tregut të punës, sipas të dhënave të

Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Të dhënat tregojnë se burrat janë të punësuar në përqindje dukshëm më të lartë se gratë. Gjithashtu, burrat trashëgojnë prona dhe pasuri nga familjet e tyre, që ua lehtësojnë investimin për ta shtuar pasurinë më vonë. Sipas statistikave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, as një e pesta e pronave në Kosovë nuk zotërohet nga gratë. Për këtë arsye, nga fshehja e pasurisë janë gratë ato që pësojnë më së shumti. Shpeshherë, edhe në kurriz të fëmijëve. Ligji për Familjen parasheh që partnerët e divorcuar, mund ta kërkojnë atë që njihet si pagesë e alimentacionit për mbajtjen e fëmijëve. Kur gjykata vendos për shumën e kësaj pagese, gjykatësi merr parasysh gjendjen financiare të prindit dhe kushtet e tij. Pa pasuri të deklaruar, një prind mund t'i shpëtojë pagesës së një shume më të madhe. Jehona tregon se gjykata ka vendosur që ish-bashkëshorti i saj të paguante 100 euro në muaj për mbajtjen e djalit të tyre. "Herë i qet, herë s'i qet", thotë Jehona. Kadolli nga RRGK-ja shprehet e shqetësuar nga moszbatimi i shumë prej vendimeve gjyqësore për pagesë të

alimentacionit. Ajo kërkon penalizime më të ashpra për ata që u ikin këtyre pagesave. "Mekanizmat, si bllokimi i llogarive bankare ose dënimet për mospagesë, rrallëherë përdoren, dhe organet përgjegjëse nuk bëjnë sa duhet për të siguruar që alimentacioni të paguhet në kohë", thotë Kadolli. Mospagesa e alimentacionit përbën vepër penale dhe Rezniciq nga IKD-ja tregon se ajo mund të iniciohet si "shmangie nga sigurimi i mjeteve të jetesës", por edhe "mospërfillje e gjykatës". "Ndryshe, vlen të ceket se legjislacioni vendor, ka përcaktuar edhe situatat kur prindi nuk arrin të ofrojë alimentacion të mjaftueshëm, që pastaj ky detyrim kalon te të afërmit e tjerë sipas radhës së trashëgimisë", sqaron Rezniciq. Të dhënat e fundit të ASK-së, nga viti 2019, tregojnë se në 75 për qind të rasteve të divorceve, fëmijët jetojnë me nënën. Kadolli beson se këto probleme sjellin pasoja jo vetëm financiare. "Ato krijojnë pasiguri dhe stres të madh te gratë, duke i bërë ato të ndihen të pafuqishme përballë një sistemi që nuk i mbron siç duhet. Është një padrejtësi që

u mohan grave dhe fëmijëve një jetë të sigurt dhe të dinjitetshme", thotë Kadolli. Për këtë arsye ajo bën thirrje që institucionet e drejtësisë - që shpesh kritikohen për mungesë serioziteti në punën e tyre - të fillojnë të luajnë një rol më proaktiv. Por, jo vetëm. Kadolli beson se si kontribut i grave duhet të njihet edhe puna e papaguar për përkujdes të fëmijëve dhe shtëpiak që ato kanë bërë gjatë martesës. "Edhe pse gratë luajnë një rol aktiv në kujdesin për familjen dhe mirëmbajtjen e shtëpisë, shpeshherë burrat e konsiderojnë kontributin financiar si të vetmin që ka vlerë", thotë Kadolli. Në Kosovë, sipas të dhënave të publikuara në tetor të vitit 2022 nga Instituti Musine Kokallari, puna e papaguar e kujdesit shtëpiak arrin vlerën mbi 1.8 miliard euro. Ai raport tregonte se gratë kalojnë mesatarisht 6.2 orë në ditë duke u përkujdesur për familjarë apo për shtëpi, ndërsa burrat 3.5 orë. Një raport i vitit të kaluar i RRGK-së tregon se gratë ndihen të mbingarkuara nga puna në shtëpi - gjë që i shtyn të mos jenë aktive në tregun e punës, e rrjedhimisht më pak të pavarura financiarisht.

GAP-i: Investimet e kosovarëve në Shqipëri më 2015-2024, rreth 360 milionë euro

PRISHTINË, 7 MARS - Instituti GAP ka publikuar një grafikë ku paraqiten investimet e shtetasve të Kosovës në Shqipëri. Në këtë grafikë, ku të dhënat bazohen në Bankën e Shqipërisë, del se investimet e kosovarëve në Shqipëri në periudhën 2015 - TM3 2024 ishin rreth 360 milionë euro. Në vitin 2015 kishte investime 3

milionë euro, në vitin 2016 ishin 11 milionë, pastaj 3 milionë më 2017, 28 milionë më 2018, 13 milionë më 2019, 14 milionë më 2020, 38 milionë më 2021. Rritje të investimeve ka pasur në vitin 2022 e tutje. Në vitin 2022 kishte 74 milionë euro investime, më 2023 kishte 95 milionë dhe 80 milionë në

vitin 2024. Referuar kësaj grafike, investimet në 22 për qind kanë shkuar në aktivitete të pasurive të paluajtshme; 18 për qind në energji elektrike, gaz; 17 për qind në industri nxjerrëse; 11 për qind në industri përpunuese dhe 10 për qind në aktivitete financiare dhe të sigurimit.



GJEOGRAFIA BËRTHAMORE E EVROPËS. SKENARËT E ARMATIMIT

Parandalimi i organizuar nga Franca dhe Britania e Madhe me Gjermaninë është e vetmja rrugë. Macron u ka hapur sytë shumë liderëve: ja çfarë mund të bëjë në terren

As dy vjet më parë, në një nëntor jashtëzakonisht të ngrohtë në Torino, profesori Romano Prodi mbajti një ligjëratë, si i ftuar në Kolegjin Carlo Alberto të Torinos, përpara dhjetëra studentëve dhe tha diçka që jo të gjithë e kuptuan: ai ftoi Francën të vinte arsenalin e saj në shërbim të Evropës.

“Po nënvlerësohet” – shpjegoi Profesori – “një pasojë shumë serioze e luftës në Ukrainë: rriarmatimi i Gjermanisë. Nuk kam frikë nga gjermanët dhe kam vlerësimin maksimal për ta, ta bëjmë të qartë. Por nëse ata ndajnë 100 miliardë euro dhe shpenzimet e tyre ushtarake arrijnë të jenë dyfishi i atyre franceze, pasojat politike janë të pashmangshme. U takon francezëve të vendosin të vihen në shërbim të Evropës. Ata kanë armë bërthamore dhe të drejtën e vetos në OKB: le t’ia ofrojnë Bashkimit Evropian”.

Më pas, përkrah kësaj intuitede të jashtëzakonshme, ai bëri një parashikim të gabuar: “Franca nuk do ta bëjë këtë, sepse të gjitha ish-perandoritë kanë zakonin të mos veprojnë duke parë përpara, por duke parë pas: është një çështje historike që e bllokoj lindjen e ushtrisë së përbashkët në vitin 1954 dhe më pas, Kushtetutën në 2005”.


Pas fjalimit të presidentit francez Emmanuel Macron, tashmë po kuptohet nga shumëkush se parandalimi bërthamor i Francës dhe Britanisë së Madhe, me bashkëpunimin aktiv të Gjermanisë së Merzit, është e vetmja rrugë që mund të na ruajë sigurinë, lirinë dhe prosperitetin evropian, përballë një Rusie kriminale dhe Shteteve të Bashkuara në duart e Trumpit.

Çfarë do të thotë “parandalim” Por për çfarë po flasim saktësisht kur përmendim fjalën “parandalim” – dhe kur këtë e bën jo një think tank luftënxitës, por demokracia franceze? Macron në fakt iu përgjigj kërkesës që kishte ardhur drejtpërdrejt nga kancelari i ardhshëm gjerman, Friedrich Merz, i cili më 20 shkurt kishte njoftuar se dëshironte të “niste negociata me Britaninë e Madhe dhe Francën, mbi mundësinë e një përdorimi të përbashkët të bërthamores ose, të paktën, mbi zbatimin e sigurisë bërthamore”.

Numri i armëve

Çfarë lloj parandalimi mund të
zbatojë në terren Evropa? Nga

-  Zotëron armë bërthamore
-  Zotëron armë bërthamore për shkak të NATO-s
-  Ka pas zotëruar armë bërthamore 



pikëpamja bërthamore, BE-ja dhe Britania e Madhe tashmë zotërojnë një numër të mjaftueshëm armësh bërthamore për të shkrumbuar çdo armik që do të kishte guxim të sulmonte kryeqytetet evropiane, ose të shkelte kufijtë e ndonjë vendi të BE.

Parisi ka rreth 300 koka bërthamore, Londra ka të paktën 260. Për sa i përket Berlinit, Gjermania zotëron armë bërthamore amerikane, por nuk ka armë bërthamore të sajat, megjithatë, në rast lufte, mund të ngrihet çështja që – me traktatet e NATO-s të pandryshuara – bombarduesit e Luftwaffes mund të përdorin rreth 160 kokat bërthamore të SHBA-ve të vendosura në Gjermani.

Secila prej këtyre kokave është shumë më e fuqishme se bomba e Hiroshimës, për të qenë të qartë. Në nëntor 2023, pikërisht ndërsa Prodi po mbante ligjëratën e sipërpërmendur në Torino, Parisi testoi me sukses raketën

balistike ndërkontinentale M51, siç e njoftoi ministri i Mbrojtjes, Sébastien Lecornu. Versioni i raketës mund të përshkojë 10 mijë kilometra dhe është një mijë herë më i fuqishëm se bomba e hedhur mbi Hiroshimë. Ai është i aftë të transportojë 10 koka bërthamore, secila e drejtuar ndaj një objekti të ndryshëm. Çdo lëshim do të ishte i barasvlershëm me shkatërrimin bërthamor të një vendi të mesëm për nga madhësia.

Rusia ka shumë më tepër koka
bërthamore (5580 sipas
Federatës së Shkencëtarëve
Amerikanë), por nga këto
vetëm 1710 janë realisht të
përdorshme (të shpërndara),
madje sipas disa studiuesve
(për shembull Benoît Grémar,
studiues në Institutin për
Studime Strategjike dhe
Mbrojtje), ky numër zbret në
1600. Po sipas Federatës së
Shkencëtarëve Amerikanë,
Shtetet e Bashkuara kanë rreth
1670 koka bërthamore gati për
përdorim.

Arsenali raketor

Fjalimi i Macron-it nënkupton gjithashtu një zgjerim të shpejtë të fuqisë parandaluese bërthamore, e cila brenda një viti mund të rritet me 100 raketa të reja, duke kaluar shifrën e 10 miliardë eurove brenda vitit. Plani i Von der Leyen flet në mënyrë të përgjithshme për 800 miliardë Euro për armë, por natyrisht, përsa i përket armëve bërthamore, vendimet do të merren nga liderët politikë.

Nga pikëpamja e PBB-së, natyrisht që BE-ja nuk ka mungesë burimesh ekonomike plotësisht të krahasueshme me ato amerikane (për të mos përmendur krahasimin me PBB-në e kufizuar të Rusisë): nëse amerikanët, tashmë plotësisht të pabesueshëm, mund të çaktivizojnë sipas dëshirës armët që shesin (për shembull duke ndalur të dhënat e inteligjencës dhe të shënjestrit për sistemet HIMARS në Ukrainë), është e pashmangshme që së shpejti porosinë evropiane për blerjen e

armëve amerikane të
përfundojnë diku tjetër. Në këtë
mënyrë, Trumpi do ta
shkatërrojë ekonominë
amerikane para se të shkatërrojë
Ukrainën.

Kufizimet e vendosura nga Traktatet

Transferimi i armëve bërthamore nga një vend në tjetrin do të përbënte, natyrisht, një shkelje të Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore (TNP), shpjegon për shembull Center for Strategic and International Studies (CSIS). Por qendra gjithashtu kujton se Vladimir Putini e ka shkelur tashmë në mënyrë të përsëritur, duke zhvendosur armë bërthamore në Bjellorusi dhe duke marrë raketa balistike nga Korea e Veriut.

Pra, një traktat që, në një luftë të hapur si ajo në të cilën ndodhemi, nuk mund të shkelet nga armiqtë tanë dhe të respektohet vetëm nga ne.

| *La stampa – bota.al*



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova U17 barazon ndaj Andorrës

Përfaqësuesja U17 e Kosovës në konkurrencën e meshkujve e ka nisur me barazim raundin e dytë kualifikues të Ligës B për Kampionatin Evropian 2025 që po zhvillohet në Qipro. Të përzgjedhurit e Arbnor Morinës janë ndalur në barazim pa gola (0:0) nga Andorra, në kuadër të Grupit 4. Në përgjithësi iniciativa ishte në anën e Dardanëve U17, por çaluan në konkretizimin e rasteve të krijuara. Në anën tjetër, Andorra u përqendrua në lojë defanzive dhe nuk lejoi shumë hapësira. Madje në minutën e 65-të Andorra kishte mundësi të mirë për t'i zhblllokuar shifrat, por Hugo Pinto nuk realizoi nga penalltia. Ndeshjen e radhës Kosova U17 e zhvillon kundër Moldavisë, më 10 mars, derisa në fund ballafaqohet me Qipron, më 13 mars.

Përballje interesante në elitën e basketbollit



PRISHTINË, 7 MARS - ProCredit Superliga vazhdon ndeshjet interesante në fundjavë, ku zhvillohet java e 23-të. Kampionati po shkon drejt fundit të garave të rregullta, ku secila ndeshje është më e rëndësishme se tjetra dhe lufta

SUPERLIGA - Java 23

Të shtunën takohen:
20:00 Proton Cable Prizreni - Peja
20:00 Bora - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:
20:00 G. Eagle Ylli - Trepça
20:00 Vëllaznimi - Bashkimi

për çdo pozitë në tabelë është e madhe. Proton Cable Prizreni do të ndeshet me Pejën, ku të dy skuadrat luajnë vetëm për fitore. Prizrenasit janë në vendin e tetë në renditje me pesë fitore e 17 humbje, kurse pejanët në vendin e katërt me 11 fitore e 11 humbje. Derbi prishtinas zhvillohet të shtunën mbrëma mes Borës dhe Sigal Prishtinës, dy skuadra që kanë pasur formë të lartë në vitin 2025 në elitën e basketbollit. Bora ka tri fitore në katër ndeshjet e fundit, ndërsa bardhekaltrit tetë fitore në tetë sfidat e fundit. Ky është

edicioni i parë i Borës në elitë, ku kërkon "play-off"-in, derisa renditet e shtata me tetë fitore e 14 humbje, kurse Sigal Prishtina e treta me 14 fitore e tetë humbje. Të dielën përballen finalistët e edicionit të kaluar Golden Eagle Ylli dhe Trepça. Therandasit renditen në pozitën e gjashtë me nëntë fitore e 13 humbje, derisa mitrovicasit kanë 15 fitore e shtatë humbje, aq sa ka edhe Bashkimi, që përballlet me Vëllaznimin në Gjakovë. Kuqezinjtë numërojnë 11 fitore e 11 humbje, andaj pritet një sfidë mjaft interesante.

SHKURT

FGJK-ja më 15 mars organizon 'Gjimnastradën 2025'

Federata e Gjimnastikës e Kosovës ka bërë me dije se më 15 mars, me fillim nga ora 11:00, në ambientet e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, sipas kalendarit të garave të kësaj federate, organizon "Gjimnastradën 2025". FGJK-ja ka njoftuar se ky aktivitet është i hapur për publikun, dhe i fton të interesuarit të marrin pjesë në këtë event ku do të përformojnë gjimnastet e klubeve të Kosovës. "Aktiviteti është i hapur për publikun, prandaj ju ftojmë të gjithëve të vini të shikoni performancat e bukura të gjimnasteve tona! Afati për regjistrim të gjimnasteve për Gjimnastradë për Klube vazhdon të jetë i hapur deri më 10 mars 2025", thuhet në njoftimin e FGJK-së.

FC Drenica, fituese e turneut 'Adem Jashari' në futsall

FC Drenica iu gëzua trofeut në turneun tradicional të futsallit "Adem Jashari", i cili u zhvillua më 5 e 6 mars në Skenderaj. Ky aktivitet u bashkorganizua nga komuna e Skenderajt, Federata e Futbollit e Kosovës dhe FC Drenica Futsal, në kuadër të shënimit të 27-vjetorit të Epopesë së UÇK-së. Në ndeshjen finale Drenica shënoi fitore bindëse ndaj Mabetex Prishtina, me rezultat 6:1. Paraprakisht në gjysmëfinale Drenica e mposhti Liqenin, 4:2, derisa Mabetex Prishtina fitoi ndaj Vjosës, 2:1.

Sonte dy ndeshje në Superligën e hendbollit

Gara në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt) vazhdon të shtunën kur zhvillohen dy ndeshje të xhiros së 21-të. Nga ora 19:30 në palestrën "Mizahir Isma" takohen Rahoveci e Llapi. Kampioni në fuqi, Rahoveci, është favorit i madh. I ka fituar 19 ndeshjet e deritashme dhe synon edhe fitoren e 20 rresht. Rahoveci është lider me 38 pikë. Llapi renditet i gjashti me nëntë pikë. Gjysmë ore më vonë fillon ndeshja mes rivalëve tradicionalë, Kastriotit dhe Trepçës. Kjo ndeshje luhet në Ferizaj. Favorit është ekipi vendas, Kastrioti, që është i treti në tabelë me 28 pikë nga 19 ndeshje. Trepça është e teta, përkatësisht e fundit, me gjashtë pikë. Në Ligën e Parë të hendbollistëve është java e nëntë. Të shtunën (19:30) është ndeshja Ulpiana - Istogu. Të dielën (19:00) takohen Prizreni e Drenica. Ndeshja në mes të Dritës e Deçanit zhvillohet më vonë.

Ferizaj mposhti Suharekën

Ferizaj, 7 mars - Ferizaj ka arritur një fitore të madhe në javën e 23-të në Superligën e Kosovës në futboll. Ferizajasit triumfuan 3-1 në shtëpi ndaj Suharekës, duke arritur kështu

tri pikë të mëdha në luftë për mbijetesë. Albion Kurtaj kaloi vendasit në epërsi në minutën e 14-të me gol nga penalltia. E në minutën e dytë shtesë, Edon Sadriu e dyfishoi epërsinë e

vendësve. Shpresat u rritën për suharekasit kur Mevlan Zeka shënoi nga penalltia në minutën e 77 për 2-1. Megjithatë, tërësisht shpresat u shuan në minutën e 87 kur

Ferizaj e shënoi edhe golin e tretë dhe e vulosi fitoren. Me këtë triumf, Ferizaj shkon në kuotën e 29 pikëve në vendin e gjashtë, kurse Suhareka bie e shtata me tri pikë më pak.



Triumfojnë lakersat, Bostoni dhe Chicago

LOS ANXHELOS, 7 MARS - Fitorja e tetë radhazi për lakersat, që fituan me rezultat 113-109 ndaj New Yorkut pas kohës shtesë, duke qëndruar në vendin e dytë në Perëndim. Donqiqi me 32 pikë e Jamesi me 31 pikë bënë dallimin në fushë për kalifornianët, duke i bërë të pavlefshme 39 pikët e

Brunsonit për nju-jorkezët. Fitore të lehtë korri skuadra e Bostonit, që mban vendin e dytë në Lindje. Ekipi i Celticsit fitoi me rezultat 123-105 ndaj Philadelphia's. Jayson Tatumi me 35 pikë ishte lider për Bostonin. Jashtë fushës fitoi Houstoni, që

mundi me rezultat 109-97 New Orleansin, ndeshje ku tre lojtarë të ekipit teksan realizuan mbi 20 pikë. Në sekondat e fundit fitoi edhe Chicago, që mundi me shifrat 125-123 Orlandon, ndeshje ku spikati Coby White, autor i 44 pikëve. Skuadra e Atlantës, falë 50 pikëve të ardhura nga

lojtarët e stolit, mundi me rezultat 124-119 Indianan, ndërsa Golden State triumfoi me rezultat 121-119 ndaj Brooklynit, ndeshje ku u dallua Stephen Curry me 40 pikë. Rezultatet: Orlando-Chicago (123-125), Atlanta-Indiana (124-118), Boston-Philadelphia



(123-105), Brooklyn-Golden State (119-121), New Orleans-Houston (97-109), Lakers-New York (113-109).

Kumbulla kujton Ligën e Konferencës: Finalja e Tiranës, një nga çastet më të bukura të jetës

BARCELONË, 7 MARS - Në një intervistë për "Cronache di Spogliatoio", Marash Kumbulla, mbrojtësi i huazuar nga Roma tek Espanyol, ka folur për periudhën e tij të verdhekuqtë: "Në ato vite me Romën në Evropë, veçanërisht në sezonin kur fituam Ligën e Konferencës dhe atë kur arritëm në finalen e Ligës së Evropës, ishte e pamundur të mos fitonim. Tifozët na shtynin përpara, atmosfera ishte e pabesueshme. Më kujtohet magazinieri i klubit, Roberto, që më bënte shumë për të qeshur kur isha në stol. Ai kthehej nga ne dhe thoshte: Si mund të mos fitojmë me këtë atmosferë? Stadiumi ishte i mbushur plot".



A e ndjetë peshën e çmimit të kartonit tuaj?

Kumbulla: Në fillim isha i ri dhe nuk mendoja shumë për këtë, doja vetëm të luaja. Kishim ndeshje çdo tri ditë dhe nuk kishte kohë për të menduar. Tani, duke parë pas, kam fituar shumë vetëdije për veten, jam pjekur shumë taktikisht, teknikisht dhe fizikisht. Për fat të keq, dëmtimi ma ndaloi rritjen, por tani jam këtu për të vazhduar zhvillimin tim.

Çfarë emocionesh përjetuat duke fituar Ligën e Konferencës në vendlindje?

Kumbulla: Nuk e kisha imagjinuar kurrë që do të fitoja një trofe në Shqipëri. Ishte fat që finalja e Ligës së Konferencës u luajt pikërisht në Tiranë, kështu që nuk mund të përfundonte ndryshe. Ishte një nga momentet më të bukura të jetës sime, sepse për mua simbolizonte mbylljen e një cikli. Të fitonim edicionin e parë të Ligën e Konferencës në Tiranë, në shtëpinë time, dhe pastaj një ditë më vonë të

festonim në Romë me mijëra njerëz ishte diçka e pabesueshme.

Çfarë kujtimesh keni nga finalja e Ligës së Evropës?

Kumbulla: Atë finale e përjetova nga jashtë për shkak të dëmtimit dhe, për fat të keq, përfundoi keq. Ishte edhe më e dhimbshme, jo vetëm sepse nuk isha në dispozicion për të luajtur, por edhe sepse humbëm me penallti. E dimë të gjithë si shkoj, nuk duhej të kishte shkuar kurrë deri te penalltitë.

Pse e latë Romën për Espanyol?

Kumbulla: Ky klub më ka dhënë vazhdimësi në aktivizim. Kur mundëm Real Madridin, as vetë nuk e besoja. 'Los Blancos' janë një skuadër që nuk dorëzohet kurrë. Edhe kur gjyqtari fishkëlleu përfundimin e ndeshjes, ende isha në tension, sepse nuk më dukej e vërtetë.

Si e gjykon vendimin e tij me

kalimin e kohës?

Kumbulla: Jam i lumtur që zgjodha këtë skuadër. Pas dëmtimit, kisha nevojë të luaja. Sapo më telefonuan, për një ditë e gjysmë isha këtu. Kisha parë tashmë stadiumin dhe qendrën sportive me kombëtaren. Janë dy struktura të pabesueshme dhe shumë moderne. Për një futbollist është e rëndësishme të kesh kushte të mira pune, sepse kështu qëndron më shumë në qendrën sportive, kalon më shumë kohë me shokët e skuadrës dhe grupi bëhet më i bashkuar.

Si përjetohet derbi?

Kumbulla: Të kesh Barcelonën afër më ka bërë të kuptoj sa shumë janë të lidhur tifozët e Espanyol me skuadrën e tyre. Ata gjithmonë thonë se 'Espanyol është një ndjenjë'. Stadiumi është gjithmonë plot, ka shumë abonentë që e kanë këtë ekip në zemër. Tifozët tanë janë të vërtetë.

SHKURT

Kimmich do të rinovojë me Bayernin deri më 2029

Bayern Munchen dhe Joshua Kimmich kanë finalizuar të gjitha dokumentet për kontratën e re e cila do ta mbajë mesfushorin gjerman në "Allianz Arena" deri në qershor të vitit 2029. Sipas raportimeve të "BILD", marrëveshja është arritur dhe firma mbi kontratë pritet të vijë shumë shpejt. Kimmich nuk ka zhvilluar bisedime të avancuara me asnjë klub tjetër pavarësisht prej interesimit dhe qasjeve të disa skuadrave. Për mesfushorin, prioriteti ka qenë gjithmonë të vazhdojë te Bayern Muncheni. Ky rinovim vjen si një sinjal i qartë nga klubi bavarez për të mbajtur një nga lojtarët më të rëndësishëm të skuadrës në vitet e ardhshme.

Guardiola: Gundogan qëndron edhe një vit

Trajneri Pep Guardiola ka konfirmuar se mesfushori veteran Ilkay Gundogan ka të ngjarë të qëndrojë në Manchester City edhe sezonin e ardhshëm. Ish-kapiteni 34-vjeçar iu bashkua Cityt me një kontratë njëvjeçare me opsionin e rinovimit të tij edhe për 12 muaj të tjerë verën e kaluar, pasi kaloi një sezon me Barcelonën.

Ky opsion mund të aktivizohet nëse gjermani, i cili ka luajtur 37 herë në sezonin 2024-2025, bën një numër të caktuar paraqitjesh dhe Guardiola ka zbuluar se klauzola është afër aktivizimit. "Unë mendoj se po. Qëndrimi i Gundogan me ne edhe sezonin tjetër është afër realizimit", ka thënë Guardiola.

Ranieri: Ndeshja e kthimit do të jetë e vështirë

Pas triumfit të Romës në Ligën e Evropës kundër Athletic Bilbao's, trajneri Claudio Ranieri është shprehur i kënaqur me fitoren dhe paraqitjen e të besuarve të tij por, sipas tij, sfida kthyesë nuk do të jetë aspak e lehtë. "Ideja është që gjithmonë të kemi sa më shumë opsione përpara se të fillojë ndeshja. E dimë forcën e një kundërshtari si Athletic, ndaj na pret një sfidë shumë e vështirë", ka thënë Ranieri. Sipas tij, gjasat për kualifikim në çerekfinalet e kësaj gare janë të barabarta. "Nëse shohim në tërësi, mund të themi se është 50-50 mes nesh dhe atyre", ka shtuar Ranieri.

Real synon transferimin e dy mbrojtësve të Liverpoolit

Real Madridi ka hedhur sytë prej kohësh nga Liverpooli, ku thuhet se ka siguruar transferimin e mbrojtësit Trent AlexanderArnold. Atij i skadon kontrata në fund të sezonit dhe do të largohet me koston zero. "Los Blancos" e ka ndër mend të bëjë një tjetër goditje të fortë te "Reds"-i, skuadra që kryeson në Angli. Sipas "Daily Mail", presidenti Florentino Perez po ndjek me interesim edhe mbrojtësin Ibrahima Konate. Kontrata e 26-vjeçarit francez skadon në verën e vitit 2026, ndaj ai do të hyjë së shpejti në vitin e fundit të kontratës. Kjo do ta ndihmojë Realin të bëjë një ofertë jo shumë të lartë, duke e detyruar Liverpoolin ta pranojë atë. Konate është një profil që i pëlqen Real Madridi, i gatshëm të përfitojë nga mosmarrëveshja e tij me "Reds", që nga frika se mos e humbet edhe këtë lojtar me koston zero, mund ta shesë.

Mourinho sulmon sërish Galatasarayn

Polemika në mes të Jose Mourinhos dhe Galatasarayt nuk ndalet. Trajneri portugez, në një intervistë për "TNT Sport", është rikthyer të denoncojë atë që e cilëson si "sistem": "Këtu në Turqi nuk bëhet fjalë vetëm për një

rivalitet futbollistik, por për një sistem të dominuar nga një klub i vetëm, i cili përcakton kampionatin. Kjo nuk vjen erë e mirë. Fenerbahçe është një klub që po përpaket me dëshpërim ta thejë dominimin e Galatasarayt, por këtu nuk

bëhet fjalë për epërsi thjesht futbollistike, por për një sistem dominues. Dhe kjo e bën punën tonë shumë të vështirë. Unë punoj për një klub të madh, një klub transparent dhe të pastër, që dëshiron të fitojë dhe ta pastrojë kampionatin turk në

mënyrën më të drejtë". Mourinho foli edhe për evolucionin e tij si trajner: "Kam ndryshuar për mirë. Mendoj se jam një trajner më i mirë se në të kaluarën, me më shumë përvojë dhe për të cilin gjithçka duket si një 'deja vu'. Mendoj

më pak për veten dhe më shumë për të tjerët; për lojtarët e mi, drejtuesit, tifozët e klubit. Ndihej shumë më mirë tani se më parë. Sigurisht, kam ndryshuar fizikisht, por si trajner mendoj se jam më i mirë se në të kaluarën".



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Drita-R4” SH.P.K. pronar Sabri Bunjaku, me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810524779 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Drita-R4” D.O.O. Sabri Bunjaku Gnjlane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810524779 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Drita-R4” L.L.C. Sabri Bunjaku with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 810524779 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arianit Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.M.M. “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Qendra Rekreative “Pallma” B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 811608259 të lëshuar nga ARBK.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

